

Në bazë të nenit 172 të Ligjit për arsimin e lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018“ dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 178/2021“), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, shpallet

## **KONKURS**

për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës

Shpallet Konkurs për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës:

### **FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE**

1. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Kardiologji, Të tjera (30209, 30225 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

### **FAKULTETI FILOLOGJIK**

1. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Pedagogji dhe Didaktikë (50500, 50501 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

### **FAKULTETI I ARTEVE**

1. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore për lëndët profesionale-artistike në lëmin Vizatim (60700 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
2. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore për lëndët profesionale-artistike në lëmin Arti i hershëm i krishterë, Arti perëndimor mesjetar, Arti mesjetar bizantin, Arti kombëtar mesjetar, Arti i rilindjes – i përgjithshëm, Arti i rilindjes – kombëtar, Arti barok – i përgjithshëm, Arti barok - kombëtar (60600, 60601, 60602, 60603, 60605, 60606, 60607, 60608 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

### **FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE**

1. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Biofizika, Fizika atomike dhe molekulare, Fizika e gjendjes së ngurtë (10303, 10302, 10308 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

**Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:**

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent, nëse e posedon;
- Diplomë për kryerjen e studimeve deridiplomike;
- Diplomë për kryerjen e studimeve të magjistraturës;
- Diplomë për gradën shkencore doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;

- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;

- Biografi e shkurtër;
- Ta dorëzojë punimin e doktoratës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

### **Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore në lëndët profesionale-artistike docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:**

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent, nëse e posedon;
- Diplomë për kryerjen e arsimit të lartë dhe marrjen e gradës shkencore magjistër i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;

- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;

- Biografi e shkurtër;
- Ta dorëzojë punimin e magjistraturës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

\*Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore dhe në thirrje mësimore-shkencore për lëndët profesionale artistike, të parapara me nenet 166 dhe 167 të Ligjit për arsimin e lartë.

\*Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Rektoratin e Universitetit të Tetovës, në adresën: Rektorati i Universitetit të Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. Tetovë.

**Universiteti i Tetovës**